



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegji "UBT" dega në Ferizaj:
 - Juridik, LLB, 240 ECTS, dhe
 - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS.
2. Hiqet masa e pezullimit për programin e studimit:
 - E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane e Biznesit, MA, 60 ECTS.
3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencia e Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, BPrAL Kolegji "UBT" ka dorëzuar listat e kërkuara nga AKA për programet e studimit.

Bazuar në të dhënat e prezantuara nga ky IAL, për programet e studimit: Juridik, LLB, 240 ECTS, dhe Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS, (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018) konfirmohet se për këto programe të studimit BPrAL Kolegji "UBT" nuk ka staf akademik të fushës së studimit. Për programin e studimit Juridik, LLB, 240 ECTS, BPrAL Kolegji "UBT" si bartës të këtij programi ka prezantuar: Sevdail Demiri, Suzana Mehmedi dhe Qebir Avziu. Bazuar në nenin 26 pika 5.3.4 nga IAL-të kërkohet që për çdo 60 ECTS të kenë të paktën një bartës të programit me gradën shkencore Dr.sc. në marrëdhënie të rregullt

të punës dhe të jetë i fushës së programit të studimit. Nga trajtimi i dokumentacionit për bartësit e këtij programi u konstatua se vetëm Suzana Mehmedi ka dokumentacion të rregullt dhe është e fushës së programit të studimit. Sevdail Demiri është Dr.sc në Histori, dhe rrjedhimisht nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit. Mbi këtë bazë, KSHC në mungesë të stafit akademik sipas nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për programin e studimit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS, BPrAL Kolegji "UBT" ka paraqitur këta persona si bartës të këtij programi të studimit: Eda Mehmeti (Dr.sc. Shkenca të Natyrës), Artan Luma (Dr.sc në Shkenca Kompjuterike), Suzana Aliu (Dr.sc në Kimi), Halil Snopçe (Dr.sc në Shkenca Kompjuterike) (F) Agni Aliu (Dr.sc në Administratë Publik), dhe Azir Aliu (Dr.sc në Informatikë).

Nga stafi i prezantuar më sipër, vetëm Artan Luma dhe Azir Aliu, plotësojnë kushtet për të qenë bartës të programit, ndërsa Halil Snopçe është i fushës së programit të studimit, por nuk ka konfirmim nga vendi shtetësinë e të cilit e ka, se nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës në vendin e origjinës, për këtë arsyeje nuk mund të pranohet si bartës i programit të studimit. Ndërsa Eda Mehmeti, Suzana Aliu, dhe Agni Aliu nuk mund të jenë bartës të programit, pasi që nuk i përkasin fushës së studimit. Mbi këtë bazë, KSHC në mungesë të stafit akademik sipas nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuara nga ky institucion, u konstatua që nuk ka staf akademik të mjaftueshëm sipas kërkesave që dalin nga neni 26, pika, 5.3.9. e UA për Akreditim. Sipas kësaj dispozite: "Kriteret e lartpërmendura për stafin akademik apo titujt e barasvlershëm artistik do të kërkohen edhe për secilin program studimi që ofrohet në degë apo kampuse tjera, përpos kampusit kryesor". Kjo dispozitë i referohet nenit 26, pika 5.3.4.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve". Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore PhD dhe të jetë i fushës së programit të studimit.

Në nenin 21, pika 1 e UA për Akreditim (9/2017), thuhet se: "AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 26 të UA për Akreditim thuhet: "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur". Bazuar në këtë çka u tha me sipër dhe në mungesë të stafit akademik, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për programin e studimit, E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane e Biznesit, MA, 60 ECTS, pas vlerësimit të dokumentacionit të ofruar nga ky institucion për stafin akademik si bartës të këtij programi, KSHC vlerësoi që ky program ka staf akademik me gradën shkencore Dr.sc., dhe janë të fushës së programit të studimit, dhe mbi këtë bazë, KSHC bazuar në nenin 26, pika 5.3.4, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "UBT";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

G. Luboteni

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

